



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Këshilltar/e për Avokim dhe Politika

Pozita	Këshilltar/e për Avokim dhe Politika (Advocacy and Policy Advisor)	
Periudha e punësimit (Prej – Deri)	mars 2023	31 korrik 2026
Lokacioni	Prishtinë	
I raporton	Udhëheqësit të Programit/Chief of Party	

Për KCSF

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), është organizatë udhëheqëse në përkrahjen e nismave qytetare në Kosovë që nga viti 1998. KCSF ofron fonde për shoqërinë civile nëpërmjet mekanizmave e sistemeve të avancuara të dhënies së granteve, ndërton kapacitete e dije për sektorin nëpërmjet Qendrës së KCSF-së, si dhe mbron dhe shtyn përpara hapësirën për qytetari dhe ambientin e veprimit të shoqërisë civile në Kosovë dhe më gjerë, nëpërmjet hulumtimit të politikave, avokimit dhe mobilizimit të sektorit. KCSF beson që një shoqëri civile e fuqishme me përfshirje të vërtetë të qytetarëve në punën e vet është element kyç për një qeverisje përfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse, e që kontribuon në shndërrimin e Kosovës në një shoqëri demokratike me perspektivë të integritetit evropian dhe me një situatë të avancuar socio-ekonomike.

Programi për angazhim të qytetarëve - Citizen Engagement Activity (CEA)

Programi për angazhim të qytetarëve - Citizen Engagement Activity (CEA) është një program pesë vjeçar i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) i cili financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Programi do të përkrahë aktivitete të shumta të cilat synojnë përmirësimin e lidhjes së shoqërisë civile me qytetarë, bashkëpunimin brenda sektorit dhe me sektorë të tjerë, si dhe diversifikimin e burimeve të shoqërisë civile përtej fondeve të donatorëve të huaj me qëllim të fuqizimit të pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies të institucioneve publike dhe të OShC-ve ndaj publikut.

Bazuar në përvojën e gjatë dhe ekspertizën e KCSF-së në zhvillimin e shoqërisë civile, duke përfshirë qasje të reja që kanë për qëllim ndërlidhjen e organizatave të shoqërisë civile me qytetarë dhe qytetare të Kosovës, dhe në bashkëpunim me organizata vendore dhe ndërkombëtare, CEA do të kontribuojë drejt arritjes së objektivave në vijim:



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Objektiva 1 – Fuqizimi i bashkëpunimit të shoqërisë civile me qytetarë dhe qytetare të Kosovës, nxitja e aktivizimit komunitar dhe rritja e kërkesës për llogaridhënie.

Objektiva 2: Krijimi i partneriteteve brenda dhe ndërmjet sektorëve dhe rritja e besimit mes OShC-ve, qytetarëve, sektorit privat dhe institucioneve publike.

Objektiva 3: OShC me njohuri e aftësi të shtuara që e shfrytëzojnë kuadrin e përmirësuar ligjor dhe zhvillojnë kulturën e përkrahjes së aktiviteteve jo-për-përfitim nga burimet vendore dhe të diasporës

Për pozitën

Këshilltari/ja për Avokim dhe Politika udhëheqë aktivitetet e programit që kanë të bëjnë me analiza ligjore, të politikave dhe rregullative për temat kryesore të programit si, filantropia, raportimi financiar për OJQ, fondet publike për OJQ, këshilla ligjore për OJQ-të lidhur me aktivitetet e tyre avokuese, etj. Përmes angazhimit të vet, Këshilltari/ja në bashkëpunim të ngushtë me Udhëheqësin e Programit do të kontribuojë në rritje të transparencës së OJQ-ve, rritjen e transparencës së financimit publik për OShC-të, avancimin e ambientit ligjor dhe rregullativ për zhvillim të filantropisë në Kosovë, si dhe promovimin e mundësive për punë vullnetare.

Gjithashtu, Këshilltari/ja do të kordinohet me ekipin e CEA-s që të mbledhë të dhëna për monitorim, vlerësim dhe mësim, si dhe të identifikojë rastet e suksesit e të promovimin e tyre.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Planifikon, zbaton dhe mbikëqyrë zbatimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me analiza ligjore dhe të politikave, përfshirë përgatitjen e raporteve dhe promovimin e vazhdueshëm të aktiviteteve;
- Komunikon në mënyrë të rregullt, kordinon punën dhe i mbikëqyrë partnerët dhe kontraktorët vendorë dhe ndërkombëtarë në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Bashkëpunon me Udhëheqësin e Programit, Zëvendës Udhëheqësen e Programit dhe Udhëheqësit/et e Komponenteve për zbatimin efektiv dhe ndërlidhjen e aktiviteteve të programit, përfshirë orientimin strategjik të programit;
- Në bashkëpunim me partnerët e programit, zbaton dhe mbikëqyrë përkrahjen ligjore dhe për avokim për organizata të shoqërisë civile;
- Në bashkëpunim me stafin e KCSF-së dhe partnerët e programit, dizajnon, mbikëqyrë dhe angazhohet në avokim për ndërtimin dhe zbatimin e sistemit për raportim financiar për OJQ-të;



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



- Në bashkëpunim me stafin e KCSF-së dhe partnerët e programit, dizajnon, mbikëqyrë dhe angazhohet në avokim për përmirësim të ambientit rregullativ për filantropi, monitorim të fondeve publike, si dhe angazhim vullnetar;
- Kontribuon në mbledhjen e rregullt të të dhënave relevante për sistemin e monitorimit dhe vlerësimin;
- Në bashkëpunim me Udhëheqësit/et e Komponenteve, dhe Zyrtaren për Komunikim me Publikun, identifikon dhe promovon nisma të suksesshme nga aktivitetet e programit;
- Bën përcjelljen e vazhdueshme të zhvillimeve ligjore dhe politike në fushat e ndërlidhura me programin;
- Kryen hulumtime dhe analiza mbi çështjet e politikave publike të cilat ndërlidhen me temat e programit, si filantropia, raportimi financiar për OJQ-të, angazhimi i qytetarëve në politikë-bërje, etj.

Kualifikimet

- Diplomë e studimeve bazike (Bachelor) në Juridik, Administratë Publike, Shkenca Politike apo fusha tjera të ndërlidhura në kuadër të shkencave shoqërore;
- Së paku pesë vite përvojë në punën me programe në fushën e qeverisjes, me preferencë në hulumtime dhe procese avokuese për ndryshim të politikave në nivel qendror;
- Së paku dy vite përvojë menaxheriale;
- Njohuri të parimeve dhe praktikës së funksionimit të politikë-bërjes në Kosovë, dhe përvojë bashkëpunimi me institucione publike;
- Përvojë e dëshmuar e punës me partnerë dhe/ose hisedarë;
- Përvojë pune me organizata të shoqërisë civile dhe nisma qytetare;
- Aftësi të shkëlqyera organizative;
- Njohuri bazike të sistemeve për Monitorim dhe Vlerësim;
- Aftësi të shkëlqyeshme të shkrimit në gjuhën shqipe dhe angleze, ndërsa aftësitë e njëjta në gjuhën serbe do të konsiderohen përparësi.

Përderisa kualifikimet e mësipërme janë obligative, preferohet që kandidatët(et) të kenë edhe:

- Përvojë pune me projekte të USAID, apo donatorëve tjerë ndërkombëtarë;
- Përvojë të drejtpërdrejtë në përkrahje të organizatave të shoqërisë civile dhe nismave qytetare;
- Leje të vozitjes, Kategoria B.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Si të aplikohet

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- CV, me tre kontakte si referenca;
- Letër motivimi me theks në përvojën dhe njohuritë tuaja për pozitën përkatëse;
- Certifikatat relevante për pozitën.

Dokumentet e mësipërme duhet të dërgohen në email adresën aplikimi@kcsfoundation.org deri më **14 shkurt 2023**, në orën **23:59**. Në fazën e parë të aplikimit, nuk kërkohet dërgimi i asnjë informate apo dokumenti shtesë.

Siguria e të dhënave dhe parimet e privatësisë janë të rëndësishme për ne. Të dhënat tuaja do t'i trajtojmë me konfidencialitet të plotë.

KCSF synon që të angazhojë një Këshilltar/e për Avokim dhe Politika, me orar të plotë, duke filluar prej muajit mars 2023. Ambienti dhe kushtet e punës janë të shkëlqyeshme ndërsa pagesa vendoset varësisht nga kandidati(ja) e përzgjedhur.

Vetëm kandidatët(et) e përzgjedhur(a) në listën e ngushtë do të kontaktohen. Varësisht nga cilësia e aplikacioneve dhe numri i kandidatëve(eve) të përzgjedhur(a) në listën e ngushtë, KCSF mund të kërkojë nga kandidatët(et) e listës së ngushtë t'i nënshtrohen testeve dhe/ose intervistave shtesë.

Në mungesë të aplikacioneve të përshtatshme, KCSF mban të drejtën që të mos përzgjedhë asnjë nga kandidatët(et) e paraqitur(a).

KCSF është organizatë e cila e vlerëson diversitetin brenda stafit, përkushtohet për mos-diskriminim dhe siguron trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve e kandidateve gjatë procedurës së rekrutimit, pa paragjykime, pavarësisht nga gjinia, raca, feja, moshë, përkatësia kombëtare, orientimi seksual, gjendja martesore, vendbanimi, nevojat e veçanta apo ngjyra.